



**BASHKIA
TIRANË**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 163, datë 18.12.2020

PËR

**NDRYSHIMIN E NJË ANËTARI NË KËSHILLIN ARTISTIKO-KULTUROR, TË
APROVUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 64, DATË 12.06.2020**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika, nënpika 1.1, shkronjat “b” dhe “d”, nenit 25, pikat 2 dhe 4, nenit 54, shkronja “ç” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 540, datë 21.12.1992, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Këshillave Artistiko – Kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre”, të ndryshuar, udhëzimit nr.1, datë 24.05.2005, të ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko – Kulturor”, vendimit nr. 157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020–2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, të ndryshuar, si dhe në vijim të memos nr 41771 prot., datë 26.11.2020, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

- 1.Të miratojë ndryshimin e një anëtari në Këshillin Artistiko, Kulturor, të aprovuar me vendimin nr. 64, datë 12.06.2020 të Këshillit Bashkiak “Për krijimin e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”;
 - 2.Anëtari i Këshillit Artistik, Z.Dorian Koçi, zëvendësohet me Znj.Asparasjana Kongo për mbulimin e fushës së rinisë, arsimit dhe shoqërisë civile.
 - 3.Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO